



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Agri Bau shpk” të datës 16.12.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi (loto I) - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-9661-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Agri Bau shpk” të datës 16.12.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi (loto I) - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-9661-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Agri Bau shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 16.12.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi (loto I) - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-9661-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1. -

Është e rëndësishme të theksohet se në momentin e ofertimit, certifikata ISO 9001:2015 ishte me afat valid, ndërsa gjatë kohës së vlerësimit ka kaluar afati i saj i vlefshmërisë. Kjo është një situatë normale, pasi certifikatat ISO kanë afat të caktuar validiteti.

Kompania jonë rregullisht pajset me standardin ISO 9001:2015 për materiale dekorative, pasi ky standard na nevojitet për veprimtarinë tonë të përditshme, si dhe për bashkëpunim me institucione publike dhe subjekte private.

P.2.-

Në letren standarde të AK-së është konstatuar se ekzistojnë marrëveshje, por se në to nuk figuron emri dhe numri i aktiviteteve të prokurimit.

Në këtë drejtim, sqarjmë se, siç shihet qartë nga kriteri i përcaktuar në NUK dhe DT, askund nuk është kërkuar që marrëveshjet për shfrytëzimin e pajisjeve të jenë të lidhura ekskluzivisht për këtë aktivitet të prokurimit, me emër dhe numër të prokurimit. Vendoqja e një kërkesë të tillë pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave për tën ndryshim të kriterëve dhe është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës, gjithashtu pika 3 e nenit 56 sqaron se:

P.3. -

Autoriteti Kontraktues, në pikën nr.3 të eliminimit, ka konstatuar se Operatori Ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë posedimin e materialeve/mostrave gjatë vizitës në terren. Ky konstatim është i pavërtetë, i pabazuar dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Dosjen e Tenderit, si dhe me faktet e dokumentuara me shkrim ndërmjet palëve.

Me email zyrtar të datës 18.11.2025, AK, përkisht zyrtari i Prokurimit Kreshnik Ismajli ka njoftuar se: Komisioni i vlerësimit do të dalë në teren dhe vizita në terren do të bëhet për verifikim të përmbyshjes së aspektit vizual 90%, duke u bazuar në deklaratën e dorëzuar nga OE.

Ne kemi paralajmëruar zyrtarin e prokurimit Kreshnik Ismajli, ZPP Visar Shehu, dhe zyrtarët tjerë të komisionit përmes emailit dhe ua kemi tërhequr vërejtjen se;

- ~~Që viti, të cilës ju i referohet në deklaratën tuaj, nuk është bërë deklarata shtetë dhe as nuk qëndron në përputhje me kërkesat e parashtruara nga ana juaj në ANEKSI-1 – Specifikimet Teknike.~~
Kërkesa juaj e përshkruar në Aneksin 1 kërkon qartë me realizimin e deklarimit në terren, pra me ekzekutimin e punimeve pas nënshkrimit të kontratës, dhe jo me verifikimin e shtetit apo inspektimin fizik të prodheve në depo.

P.4. -

Ky konstatim është jo profesional, i paargumentuar dhe plotësisht i pajzuar në faktë dhe në ligj, numëresë totale e analizës dhe krahasimit të çmimeve, Skandaloz.

Autoriteti Kontraktues, nuk ka specifikuar cilat pozicione konkrete pretendohet se janë ofertuara me çmime të larta, nuk ka identifikuar cilat pozicione pretendohet se janë ofertuara me çmime të ulëta, nuk ka paraqitur asnjë krahasim me çmime të tregut, nuk ka paraqitur asnjë analizë financiare apo teknike që do ta mbështeste këtë konstatim.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju si OE-ik me oferte financiare me çmim prej 93,340.00 EUR, Komisioni i vlerësimit pas shqyrtimit, analizimit dhe krahasimit të ofertës me kërkesat e njohurit për kontratë dhe dosjes së tenderit, konstaton se ky operator nuk është i përgjegjshëm, pasi nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kërkesave teknike dhe/ose profesionale sipas pikave 9.1 dhe 9.2 – Kapaciteti teknik dhe profesional, Konkretisht:

1. Operatori ekonomik tek Kërkesa 2 – OE duhet të jetë i licencuar me standardin ISO 9001:2015 për materiale dekorative. Dëshmia e kërkuar: Kopja e certifikatës valide sipas kërkesës.

Ju si GOE nuk ka arritur të dëshmojë këtë kërkesë, pasi ka paraqitur një certifikatë me validitet të skaduar, që është në kundërshtim me kërkesën dhe dëshminë e kërkuar.

2. GOE tek Kërkesa 3 – OE duhet të posedojë mjete dhe pajisje teknike të domosdoshme për realizimin e projektit, si dy shporta ngritëse për montim të ndriçimit dhe dekorimeve. Dëshmia e kërkuar: Deklarata doganore, librezat e qarkullimit ose marrëveshjet për shfrytëzimin e tyre. GOE nuk ka arritur të dëshmojë këtë kërkesë, pasi ka paraqitur marrëveshje për shfrytëzim të makinerisë pa emër dhe numër të prokurimit, që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

3. GOE tek Aneksi I: GOE nuk ka arritur të dëshmojë se posedon materiale ose mostra sipas parametrave të kërkuar. Komisioni i vlerësimit, gjatë vizitës në terren, ka konstatuar se konsorciumi nuk ka arritur të paraqesë materiale ose mostra dhe për këtë arsye është konsideruar jo përgjegjës.

4. GOE me ofertën e tyre për pozicionet në parantesë: GOE ka paraqitur çmime që nuk përputhen me tregun, pasi në disa pozicione ka paraqitur çmime shumë të ulëta dhe në disa pozita çmime shumë të larta, që janë sqaruar dhe interpretuar me vendimin e ZPP.

Për këtë arsye, Autoriteti kontraktues ka konstatuar se oferta e juaj është jo bindëse dhe e pa përgjegjshme dhe rrezikon ekzekutimin e projektit.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 17.12.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.